



Prishtinë, 07.10.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1431_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2216_09_21** i dt.03.09.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **23.09.2021**;

në seancën e mbajtur më datë 07.10.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** si i bazuar Kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin D.B DPR – 90094228, nga Komuna e Prishtinës.
- II. **Anullohet** Vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2216_09_21, i datës 03.09.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 03.09.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2216_09_21 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit D.B dhe e ka obliguar ndërmarrjen KESCO që të bëjë korrigjimin në vlerë prej -119.13 EUR për faturat e periudhës 10/2018 deri me 03/2019.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- KESCO konsideron se faturimi i kontestuar është i saktë dhe është bërë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor, sepse shpërndarja e kilovatëve të shpenzuar në njehsorin nr. 39563054 nga periudha 10/2018 deri me 03/2019 nuk rezulton me ndonjë korrigjim eventual, pasi faturimi i kilovatëve të grumbulluar në muajin 03/2019 është faturuar me çmimin e njëjtë, pa ngarkesa financiare shtesë.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2216_09_21 i datës 03.09.2021 për konsumatorin Driton Berisha.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë duhet te anulohet.



Pas shqyrtimit dhe administrimit të të gjitha shkresave të lëndës, e në veçanti procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit të dt. 27.09.2018, faturën e dt. 28.03.2019, ankesën e konsumatorit në KESCO të dt. 28.03.2019, përgjigjen e KESCO-s të dt. 11.05.2019, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të dt. 20.05.2019, Vendimin e DMK/ZRrE të dt. 03.09.2021, Kundërshtimin e KESCO-s të dt. 23.09.2021, Rrjedhës së Energjisë Elektrike, Transaksionet dhe Listat e Leximit, ka gjetur se, Kundërshtimi i KESCO-s është i bazuar.

Me datë 27.09.2018 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrimin e njehsorëve elektrik kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 69673561 me gjendje TL=4802 kWh dhe TU=1796 kWh si dhe ka vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 39563054 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar qe njehsori i vjetër nuk merret kurse njehsori i ri vendoset ne shtyllë.

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 28.03.2019 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën mars 2019 me 2,676 kWh apo e shprehur në vlerë financiare **170.53€**. Me datë 28.03.2019 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që ti behet ri shqyrtimi i faturave nga periudha tetor 2018 për shkak te dyshimit ne matjen dhe faturimin jo te saktë te njehsorit elektrik nr. 39563054.

Bordi ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike listat e leximit si dhe procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik, dhe ka konstatuar se, shkalla e parë në DMK, ka gabuar në rastin e korigjimit pasi qe konsumatorit nuk i takon korigjim financiar edhe përkundër shpërndarjes se kWh te faturuar ne periudhën mars 2019 per periudhën tetor 2018 deri ne periudhën mars 2019.

Po ashtu me rastin e analizës se dokumentacionit, Bordi konstaton se KESCO me rastin e faturimit të konsumatorit per periudhën pas ndërrimit te njehsorit elektrik nr. 39563054 deri ne periudhën mars 2019 nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energi ku thuhet se: *1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 07.10.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga



data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit D.B, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.